



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2988 Prot.

Lezhë, më 01.03.2021

V E N D I M

Nr 39, Datë 24 / 02 / 2021

“ Për miratimin e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore ndodhur në zonën kadastrale 8632 me nr pasurie 9/62 me adresë lagjja “Kodermarlekaj” Lezhë, në favor të poseduesve të objekteve informale”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e, në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 15/1 pika 2, në VKM nr. 611, datë 11.06.2009 “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, nisur nga kërkesa me nr.prot. 12609, datë 31.10.2019 nga ana e “Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, Drejtoria Lezhë, në lidhje me shtetasin Selami Shyqyri Terziu, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore ndodhur në zonën kadastrale 8632 me nr. pasurie 9/62 me sip 500 m² (sipas hartës treguese me ndryshimet e bëra prona me nr. pasurie 9/62 ZK 8632 me adresë lagjja Kodermarlekaj” Lezhë sipas hartës bashkëlidhur, në favor të poseduesit të objektit informal për efekt të përfundimit të procedurave të kalimit të pronësisë si më poshtë:

Selami Shyqyri Terziu

2. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve Publike dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

